



E premte, 6 Shkurt 2009

ILO/09/09

## TAKIMI I 8-<sup>TE</sup> RAJONAL EVROPIAN I ILO-S

### UDHËHEQËSIT EVROPIANË, DREJTORI I PËRGJITHSHËM I ILO-S DHE PARTNERËT SOCIALË DISKUTUAN POLITIKA KYÇE SI PËRGJIGJE NDAJ KRIZËS FINANCIARE DHE EKONOMIKE

LISBONË (Lajme nga ILO) – Një grup udhëheqësish kryesorë Evropianë u bashkuan sot me Drejtorin e Përgjithshëm të ILO-s dhe përfaqësues të partnerëve socialë, në një diskutim të nivelit të lartë mbi politika gjithpërfshirëse si përgjigje ndaj krizës financiare dhe ekonomike.

Ky panel, i cili u mbajt gjatë Takimit të 8-të Rajonal Evropian të ILO-s, analizoi një sërë masash që po merren ose që mund të merren nga qeveritë, punëmarrësit dhe punëdhënësit, për të lehtësuar impaktin negativ të krizës mbi punësimin, tregun e punës dhe kushtet sociale, si dhe për t'u përgatitur për rimëkëmbjen.

Kryeministrja e Moldavisë, Shkëlqesia e Saj, Znj, Zinaida Greceanii, ju referua masave të marra para krizës nga vendi i saj, të cilat kanë qenë të dobishme për reduktimin e pasojave negative të krizës. “Ne stimuloam zhvillimin ekonomik, investimet dhe arritëm të krijojmë vende pune. Këto masa janë veçanërisht të rëndësishme për ekonominë tonë sot. Ne gjithashtu kemi ngritur një këshill kordinator për monitorimin e zhvillimeve në sektorin tonë financiar”.

Diskutimi u drejtua nga Drejtori i Përgjithshëm i ILO-s, Z Juan Somavia, i cili vuri theksin në rëndësinë e gjetjes së një rruge për rritje ekonomike më të balancuar me qëllim rimëkëmbjen e qëndrueshme. “Modeli aktual i globalizimit – gjatë 30 vjetëve të fundit – ka ulur përqindjen e pjesëmarrjes së pagave në prodhimin kombëtar. Ne gjendemi tani para faktit ku themi se na duhet të rrisim fuqinë blerëse. Ndoshta një nga konkluzionet që ne mund të nxjerrim nga kjo krizë është se në të ardhmen pjesëmarrja e pagave në PBB duhet të jetë më e madhe se gjatë 30 viteve të fundit. Dialogu social mund të na ndihmojë të gjemë mënyrën për ta bërë këtë”, tha Z. Somavia.

Zëvendës Kryeministri Çek, Alexandr Vondra, vendi i të cilit mban aktualisht presidencën e rradhës të Bashkimit Evropian, theksoi seriozitetin e krizës ekonomike, por gjithashtu përmendi nevojën e shmangies së masave proteksioniste, të cilat mund të çojnë në një shtrembërim të tregut

Evropian. “Është e rëndësishme të rezistojmë ndaj joshjes për rritjen e proteksionizmit, si brenda ashtu edhe jashtë Evropës ... Një përjasje e kordinuar është shumë e rëndësishme”, tha ai.

Ministri i Punës i Luksemburgut, Francois Biltgen, gjithashtu ju referua nevojës për veprim të kordinuar ndërmjet vendeve: “Ne nuk do të mund të zgjidhim krizën globale me miratimin e zgjidhjeve kombëtare të pjeshme, ose duke u tërhequr mbas barrierave proteksioniste. Le të mos i kthehemi modelit të globalizimit që kemi patur më parë, sepse në të kundërt, ne do të ndeshemi me të njëjtat probleme që kemi sot, ndoshta dhe më keq”.

Ministri Portugez i Punës dhe Kryetar i Takimit të 8-të Rajonal Evropian të ILO-s, José Vieira da Silva, renditi një sërë masash për të përmbysur pasojat negative të krizës. “Ne duhet të përgjigemi ndaj mungesës së likuiditetit dhe kreditimit të ekonomisë. Ne gjithashtu duhet të stimulojmë kërkesën dhe investimet, dhe të mbrojmë vendet e punës duke përdorur gjithë instrumentat e disponueshëm, veçanërisht dialogun social. Por ne nuk duhet të harrojmë se këto investime dhe masa duhet të jenë në përputhje me reformat që do të forcojnë potencialisht rritjen në nivel lokal, rajonal apo global”.

Presidenti i Shoqatës Industriale Portugeze – Konfederata e Biznesit (AIP-CE), Z. Jorge Rocha de Matos, tha se ndërmarrjet e vogla dhe të mesme kërkojnë vëmendje të veçantë gjatë periudhës së krizës. Ai tha se është kritike të rritet likuiditeti i sistemit financiar dhe të rezistojmë ndaj joshjes për rritjen e barrierave proteksioniste. Ai gjithashtu vuri në dukje rëndësinë e promovimit të parimeve themelore dhe të drejtave në punë, sikurse dhe rëndësinë e përgjegjësisë sociale të korporatave dhe etikës në biznes.

Znj Anne Demelenne, Sekretarja e Përgjithsme e Konfederatës së Sindikatave belge (FGTB), tha se masat ishin të nevojshme si në nivel lokal, ashtu dhe në atë Evropian. “Ajo çka duam në të vërtetë të shohim është një kordinim më i mirë, për shembuill, në politikat e pagave. Ne gjithashtu duam konsultime më të mëdha dhe dialog makroekonomik midis partnerëve socialë të përmirësuar dhe më të fortë. E njëjta gjë vlen edhe për taksat.”.

---

*Shënim për korrespondentët: Për informacion të përgjithshëm mbi takimin ose për të kërkuar informacion apo kontakte të tjera, jeni të lutur të kontaktoni Departamentin e Komunikimit të ILO-s në numrin e telefonit +4122/799-7912 - [communication@ilo.org](mailto:communication@ilo.org), ose Zyrën e ILO-s në Lisbonë në numrin e telefonit +351 91 830 01 84, [santosa@ilo.org](mailto:santosa@ilo.org)*

*Për më shumë informacion mbi mbulimin, video, dokumenta dhe materiale të tjera për median, jeni të lutur të vizitoni:*

[http://www.ilo.org/global/About\\_the\\_ILO/Media\\_and\\_public\\_information/Press\\_releases/lang-en/WCMS\\_101587/index.htm](http://www.ilo.org/global/About_the_ILO/Media_and_public_information/Press_releases/lang-en/WCMS_101587/index.htm)